



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 12.05.2015,
 e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Vjollca Dibra – Ibrahimimi (LDK), Naime Osmani (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Abit Kastrati (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Genc Sherifi (LVV), Bardha Dida – Rogova (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Hatixhe Latifi – Pupovci (LVV), Qëndron Kastrati (LVV), Ylli Hoxha, shef i GP-së (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Shaip Shabani (PDK), Laura Zherka (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik (KDTP).

Munguan: Vlora Dumoshi (LDK), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Remzi Pacolli (AKR) dhe Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (LB).

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.

Para se të miratohej rendi i ditës, **Muhamet Selmani**, në emër të GP të PDK-së, kërkoi që të ndryshohet rendi i ditës, të largohen nga rendi i ditës: pika 3 – Propozimvendimi për ndryshimin – përshtatjen e profilit të rrugës së planifikuar “F-F” në mes të blloqeve “B 1” dhe “B 2” të Planit rregullues “Lakërishta” dhe pika 4 - Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes “Mati 1” (si ishte propozuar rendi i ditës) dhe që kjo të bëhet me votim për ose kundër.

Për rendin e ditës diskutuan edhe Sami Hamiti, Qëndron Kastrati, Shefki Gashi, Feti Mehdiu, Ylli Hoxha, Islam Pacolli, Agim Gashi, Sylejman Pireva, Kreshnik Ahmeti, Shaip Hajrizi dhe Dardan Sejdiu, nënkryetar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Selmani.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet e tri (23) vota për dhe njëzet (20) vota kundër (Hatixhe Hoxha, Qëndron Kastrati, Ylli Hoxha, Hatixhe Latifi - Pupovci, Teuta Krasniqi, Genc Sherifi, Sylejman Pireva, Kreshnik Ahmeti, Bardha Dida - Rogova, Mirlinda Sopi, Sofije Bunjaku, Rita Begolli, Imer Rusinovci, Fadil Gashi, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Visar Arifaj, Nenad Miladinoviqi dhe Cuneyd Ustaibo), u miratua propozimi që pika e tretë dhe e katërt e rendit të ditës(ashtu si është propozuar) të hiqen nga rendi i ditës.

U konstatua se u miratua ky

R E N D D I T E:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë;
2. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismail Qemalit;
3. Shqyrtimi i raportit financiar tremujor, për periudhën janar-mars 2015;
4. Informatë për sigurinë në komunë, me theks të veçantë siguria në shkolla;
5. Informatë për funksionimin e transportit lokal;
6. Informatë për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave;
7. Pyetje dhe përgjigje;
8. Të ndryshme.

Para se të fillonin me pikën e parë të rendit të ditës, **Shefki Gashi** kërkoi nga nënkryetari, që të ndërmer masa për tejkalimin e mosmarrëveshjes në mes të asamblistit Muhamet Selmani dhe drejtorit Liburn Aliu.

Naime Osmani, në emër të Grupit të grave, i njoftoi të pranishmit rreth një iniciative të marrë për dhurimin e gjakut. Ajo tha se këtë iniciativë e kemi marrë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe i ftoi të gjithë anëtarët e Kuvendit që t'i bashkëngjiten këtij aksioni vullnetar, që do të jetë nga ora 12:00 - 13:00.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë.

Merita Surkishi ngriti një shqetësim lidhur me mos kthimin e përgjigjeve nga ana e ekzekutivit, duke thënë se për pyetjet të cilat i kam parashtruar në mbledhjen e fundit, nuk kam marrë përgjigje, andaj kërkoj që përgjigjet të kthehen me shkrim.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Kuvendit.

Pika e dytë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismail Qemalit.

Arsyetimin për ndryshimin e vendimit e paraqiti Dardan Sejdiu, nënkryetar.

Lidhur me këtë pikë diskutuan: Kreshnik Ahmeti, Sami Hamiti, Shemsi Veseli, Islam Pacolli, Sylejman Pireva, Imer Rusinovci, Feti Mehdiu, Abetare Fazliu, Cuneyd Ustaibo dhe Nenad Miladinovic, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Visar Arifaj nuk u pajtua me propozimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Ismail Qemalit, andaj propozoi që shtatorja të vendoset në maje të objektit ish-Rilindja.

Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash për dhe një (1)votë kundër (**Visar Arifaj**), u miratua **Vendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e përmendores së Ismail Qemalit.**

Pika e tretë

Shqyrtimi i raportit financiar tremujor, për periudhën janar-mars 2015.

Lidhur me Shqyrtimin e raportit financiar tremujor, për periudhën janar-mars 2015, të pranishmit i njoftoi Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Për raportin diskutuan Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, Islam Pacolli, shef i GP të AKR-së, Imer Rusinovci, shef i GP të AAK-së, Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, Abetare Fazliu, në emër të GP të LB-së, Visar Arifaj, në emër të subjektit politik PF, Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP dhe Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik GIS, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për këtë pikë diskutuan edhe Ylli Hoxha, Agim Gashi, Flamur Shala, Shemsi Veseli, Bekim Gashi dhe Visar Berisha, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Raportin financiar tremujor, për periudhën janar-mars 2015.

Kryesuesi konstatoi se me njëzet (20) vota për dhe me njëzet e tri (23) vota kundër (Halim Halimi, Hazir Borovci, Sami Hamiti, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Abit Kastrati, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra-Ibrahimi, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Besa Rafuna, Shaip Shabani, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Laura Zherka dhe Lirijeta Rexhepi), nuk u miratua Raporti financiar tremujor, për periudhën janar-mars 2015.

Pika e katërt

Informatë për sigurinë në komunë, me theks të veçantë siguria në shkolla.

Lidhur me Informatën për sigurinë në komunë, me theks të veçantë siguria në shkolla, të pranishmit i informoi Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit.

Për këtë pikë diskutuan: Flamur Shala, Kreshnik Ahmeti, Shemsi Veseli, Islam Pacolli, Imer Rusinovci, Feti Mehdiu, Abetare Fazliu, Visar Arifaj, Agim Gashi, Ylli Hoxha, Hatixhe Hoxha, Hasime Krasniqi, Naime Osmani, Ajnishahe Azemi dhe Sofije Bunjaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për pyetjet dhe sugjerimet e parashtruara, Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për sigurinë në komunë, me theks të veçantë siguria në shkolla.

Pika e pestë

Informatë për funksionimin e transportit lokal.

Për Informatën lidhur me funksionimin e transportit lokal, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Dardan Sejdiu, nënkryetar.

Islam Pacolli kërkonte nga Komuna që mundësisht ta shqyrtojë projektimin e rrugëve në fshatin Hajvali, me qëllimin që lëvizja e linjës me autobus në këtë fshat të jetë sa më funksionale dhe racionale.

Qëndron Kastrati i sugjeroi anëtarët e Kuvendit komunal që, me një kërkesë, t'i drejtohen Ministrisë së Financave, që me prioritet t'i kryejë punët që i takojnë nivelit qendror.

Shaip Hajrizi kërkoi të dijë se çka është bërë me linjën e premtuar Kodra e Trimave – Gërmi. Njëherësh ngriti shqetësimin për sjelljet jo korrekte të disa pronarëve të autobusëve ndaj qytetarëve, në veçanti ndaj pensionistëve.

Lirijeta Rexhepi pyeti për mundësinë që të parashihet një linjë e veçantë për lagjen “Velania”, pasi që për qytetarë ka shumë probleme me transport në mungesë të linjës.

Për informatën diskutuan edhe **Shiqeri Spahiu, Naime Osmani, Sylejman Pireva, Nenad Miladinoviçiqi, Ajnishahe Azemi, Visar Arifaj, Hatixhe Hoxha, Agim Gashi, Shemsi Veseli dhe Flamur Shala**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Lidhur me pyetjet dhe kërkesat e parashtruara, **Dardan Sejdiu**, nënkryetar, dha sqarime të nevojshme.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për funksionimin e transportit lokal.

Pika e gjashtë

Informatë për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.

Lidhur me **Informatën për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave**, të pranishmit i njoftoi **Dardan Sejdiu**, nënkryetar.

Për informatën diskutuan **Naime Osmani dhe Hatixhe Hoxha**.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.

Pika e shtatë

Pyetje dhe përgjigje

Flamur Shala, shtroi pyetje për nënkryetarin e Komunës.

A e konsideroni valid vendimin që e ka lëshuar Agjencia Antikorrupsion lidhur me emrat e përfolur dhe emrat, të cilët bashkë me lëndën, kanë shkuar në Agjenci për trajtim, duke u nisur nga kryesuesi e deri tek dhjetë anëtarët e Kuvendit, që, në një mënyrë, tendenca ka qenë dyshuese, shpifëse dhe ka dalë si diçka që nuk është e vërtetë?

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Shala, Dardan Sejdiu, nënkryetar, dha sqarime të nevojshme, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Rreth çështjes së ngritur lidhur me vendimin e Agjencisë Antikorrupsion, diskutoi edhe **Qëndron Kastrati**, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Pika e tetë Të ndryshme

Mustafë Krasniqi parashtrori kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale.

Rruga që shpie në fshatin Grashticë, ku segmenti i parë është shtruar para tri vitesh, në gjatësi mbi tri kilometra, në fillim ka rezultuar me mirëmbajtje, por më vonë ajo ka mbetur pa mirëmbajtje. Tani ajo rrugë është dëmtuar shumë dhe është para shkatërrimit total të asaj pjese që ne e kemi trajtuar. Andaj, ai kërkoj nga drejtori që mundësisht të mirëmbahet rruga për Grashticë deri në lagjen lart.

Islam Pacolli paraqiti kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale.

Në fshatin Hajvali, rruga që fillon nga magjistrallja e vazhdon në drejtim të Qendra Familjare të këtij fshati, është duke u punuar, dhe ne si banorë nuk jemi të kënaqur me zhvillimin e këtyre punimeve. Në bazë të informatave që kemi, fituesi i këtij tenderi ka shkuar me çmim vetëm për ta fituar tenderin, por nuk e ka shikuar pjesën që duhet ta kryejë sipas tenderit. Ai duhet ta kryejë projektin ashtu siç është paraparë. Në këtë rrugë është duke u përdorur një material jashtëzakonisht i dobët, i cili nuk duhet të përdoret për trase rrugore, por ka edhe shmangie të gypat e ujërave atmosferike dhe ujërave të zeza, pastaj shmangia e gypit të ujësjellësit e kështu me radhë.

Ai kërkoj edhe nga nënkryetari, që këtë situatë ta marrë parasysh, si dhe kërkoj që zyrtarisht të ketë qasje në dokumentet e kësaj marrëveshje rreth realizimit të këtij projekti.

Lirijeta Rexhepi parashtrori kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale.

Ajo kërkoj që, për vitin e ardhshëm, të futet në planifikim edhe ndriçimi në fshatin Tenezhdoll. Çështja tjetër, të cilën e kishte ngritur edhe më parë, kishte të bënte me instalimin dhe ndërrimin e gypave të ujit në lagjen "Velania", projekt që me vite ka ngecur. Meqë në këtë rrugë është duke u futur një gyp i ri, ajo kërkoj që të bëhet lidhja e rrjetit të shtëpive me gypin kryesor, në mënyrë që të zgjidhet problemi dhe më pas të shtrohet edhe rruga.

Shaip Shabani shtroi pyetje për nënkryetarin e Komunës, z. Dardan Sejdiu.

Në lagjen "Bërnica", tash e një vit e gjysmë nuk jepen leje ndërtimi, andaj kisha dashur të dijë se çka është duke u planifikuar në këtë drejtim?

Shaip Hajrizi shtroi kërkesën e banorëve të rr. "Ismet Krasniqi" në Prishtinë, drejtuar Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale.

Në rrugën "Ismet Krasniqi" të lagjes "Kodra e Trimave", janë rrënuar muret e shtëpive për rregullimin e trotuarit. Është kërkesë e qytetarëve të kësaj lagjeje, që sa më parë të finalizohet ky projekt, sepse kanë mbetur shtëpitë pa mure, dhe kërkojnë që urgjentisht të intervenohet, në mënyrë që ato mure që janë rrënuar, të rregullohen ashtu si ka qenë marrëveshja në mes tyre dhe Komunës.

Shiqeri Spahiu, kërkoi edhe ndikimin e nënkryetarit, që pyetjet të cilat i ka parashtruar në muajin dhjetor të vitit të kaluar e nuk ka marrë përgjigje, t'i kthehen përgjigjet.

Këto pyetje kishin të bënin me ngritjen e nivelit të rrugë në vendkalimet e këmbësorëve ose, siç quhet ndryshe, "polic i shtrirë", të vendosur nëpër rrugë, pyetje e cila është dorëzuar me shkrim dhe ende nuk është kthyer asnjë përgjigje.

Sa i përket pyetjes lidhur me Qendrën Rekreative në Gërmi, ai kërkoi mendimin e nënkryetarit, se a e vlerëson legjitime marrëveshjen e cila është bërë në mes subjekteve, apo në mes organizatave, pa pëlqimin e Kuvendit të Komunës, për të cilin Kuvendi i Komunës ka marrë vendim, që e ka autorizuar për atë punë ndërmarrjen "Sport Marketing", ndërsa tani veprohet ndryshe, pa ripëlqim ose pa ndonjë autorizim nga Kuvendi i Komunës.

Abit Kastrati kërkoi nga nënkryetari, kryesuesi dhe nga të gjithë anëtarët e Kuvendit, që të marrin masa për tejkalimin e mosmarrëveshjes në mes të asamblistit Muhamet Selmani dhe drejtorit Liburn Aliu.

Kreshnik Ahmeti paraqiti një sugjerim për Drejtorinë e Administratës.

Ai sugjeroi që Zyra e Kuvendit ta praktikojë shtypjen e materialeve në të dy anët e letrës, për shkak të kostos së lartë të shpenzimeve.

Shemsi Veseli e përkrahu propozimin e z. Kastrati, që të gjithë së bashku të marrin masa për tejkalimin e mosmarrëveshjes në mes të asamblistit Muhamet Selmani dhe drejtorit Liburn Aliu.

Të njëjtin mendim e shprehu edhe **Feti Mehdiu**.

Lidhur me pyetjet dhe kërkesat e parashtruara, **Dardan Sejdiu**, nënkryetar, dha sqarime të nevojshme, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Mbledhja mbaroi në orën 16:45.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.